



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1312/ 3 prot

Datë 05 .07.2023

V E N D I M
Nr. 562 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.07.2023 me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-71121-05-31-2023, me objekt “*Kancelari*” me fond limit: 1.962.663 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastër.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipër cituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gjirokastër.
Adresa: Gjirokastër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*” .

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-71121-05-31-2023, me objekt “Kancelari” me fond limit: 1.962.663 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2023/3166, datë 07.06.2023 dhe me Nr. 1312/2023 prot., datë 07.06.2023 për procedurën e prokurimit sipër cituar, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 5712 prot., datë 15.06.2023, protokolluar me tonën nr. 1312/2 prot., datë 16.06.2023 me objekt “Informacion” Autoriteti Kontraktor ka trajtuar ankesën dhe është shprehur me vendim, duke e pranuar pjesërisht atë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

- Operatori ekonomik kërkon ndryshime në specifikime teknike për artikullin 13:

13	Bojë vulë blu kuti metalike	Bojë për vulë ngjyrë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave. Bojë ekologjikisht e pastër dhe rezistente. Boja vjen në paketim 30ml. Kutitë metalike
----	-----------------------------	--

Boja e vules është e ambalazhuar në shishe plastike. Kërkesa që kutitë të jenë metalike është e egzagjeruar, për sa kohë që materiali i kutisë nuk ndikon në funksionalitetin e produktit. Për këtë arsye kërkojmë që të hiqet togfjalshi “Kuti metalike”.

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se: *“Përsa më sipër pretendimi juaj qëndron.”*

- Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 23.

23	Dosje kartoni kuti arkive me lidhëse.	Të ketë përmasa 410x280x170 mm (5% marzh gabimi), material kartoni i fortë. Me kapak, karton i trashë.
----	---------------------------------------	--

Per këtë artikull doni "Dosje kartoni kuti arkive" apo "Dosje me lidhëse" ? Jemi të paqartë për kërkesën tuaj, pasi këto janë dy produkte të ndryshme. Përcaktoni qartë llojin e dosjes.

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr. 5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se: *“AK kërkon kuti arkivi me lidhëse.”*

III.1.1 Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor, për art.23 ka sqaruar se kërkon kuti arkivi me lidhëse (përmasa 410x280x170 mm (5% marzh gabimi), material kartoni i fortë. me kapak, karton i trashë) ndërkohë në tabelën e specifikimeve teknike e ka Kutitë arkive.

Autoriteti Kontraktor duhet t’i referohet të dhënave dhe llojit të Kutitë të Arkivës të cilat janë të përcaktuara me vendimin përkatës duke iu referuar vendimit **Mbi kutitë e arkivave apo dosje për ruajtje të përhershme materialeve arkivave. Gjithashtu, të përcaktoje të njëjtin emërtim në të gjitha dokumentet e tenderit.**

- Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 29.

29	Dosje të mëdha me butona A4
----	-----------------------------

Përcaktoni sa të gjera duhet të jenë dosjet. Fillojnë nga 6cm deri në 15cm

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se: *“Dosje të mëdha me butona duhet të jenë me trashësi 15 cm.”*

- Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 57

57	Kapese me vesh te vegjel 20mm	Kapsee me veshë 19 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
-----------	-------------------------------	--

Standarti i kesaj permase tek kapset me veshe eshte 19 mm (sikurse e keni shkruar tek specifikimet teknike) dhe jo 20 mm. Duhet te sakesohet emertimi i artikullit.

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se: “Emërtimi i artikullit është 19 mm.”

- Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 60

60	Kapese me vesh te vegjel 50mm	Kapsee me veshë 51 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
-----------	-------------------------------	--

Standarti i kesaj permase tek kapset me veshe eshte 51mm (sikurse e keni shkruar tek specifikimet teknike) dhe jo 50 mm. Duhet te sakesohet emertimi i artikullit.

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se: “Emërtimi i artikullit është 50 mm.”

III.1.2 Komisioni i Prokurimit Publik verën se autoriteti kontraktor, për art.60 ka pranur të saktësojë përmasën e tij ndaj duhet të vendosi të saktë përmasën për kapsee me vesh të vegjël 51 mm. **Gjithashtu të përcaktoje të njëjtin emërtim në të gjitha dokumentet e tenderit.**

- Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 78

78	Letër e tejdukshme (kalk) A4.	
-----------	-------------------------------	--

Sa fije kalk duhet të ketë një pako?

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se: “Një pako duhet të ketë 100 fije.”

- Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikujt 106 dhe 107

106	Marker I kuq Maxx 290
107	Marker I zi Maxx 290

"Maxx 290" eshte nje produkt specifik i markes Schneider Ju kujtojme se kjo kerkese eshte ne kundeshiti me Nenin 36 LPP. Nr 162/2020 , pika 4... kerkojme qe te hiqet kerkesa qe markeri te jete " Maxx 290" , per sa kohe qe LPP nuk e lejon kete gje."

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se: “Përsa më sipër pretendimi juaj qëndron, specifikimi Maxx 290 do të hiqet.

- Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikujt 174, 175,176 dhe 177: *Mqs kerkoni nje vule te personalizuar, duhet te publikoni modelin e vules dhe permasat e peraferta te saj.*

174	Vule per "Kinema Gjirokaster"
175	Vule per biblioteken "A Meksi"
176	Vule per biblioteken "T Gjokuta"
177	Vule per teatrin Zihni Sako

- Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së ka bashkëlidhur modelin duke cituar: *Modeli është si në foto ose ekuivalent.*

III.1.3 Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-71121-05-31-2023, me objekt “*Kancelari*” me fond limit: 1.962.663 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastër, dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Referuar Neni 2 i ligjit 162/2021 “*Për Prokurimin Publik*” parashikon shprehimisht se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3, “*Parime të përgjithshme*” i ligjit 162/2021 “*Për Prokurimin Publik*” parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Neni 36 “*Specifikimet teknike*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorhet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuar plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike

ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.1 Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Në pikën 2 të nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

III.3 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik, “Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit

dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III. 3.1. Operatori ekonomik ankimues pretendon ndryshime: • *Ne shtojcën 6 “Formulari i sasise dhe grafiku i lëvimit” është përcaktuar se afati levrimit të mallit për këtë procedurë do të jetë 15 ditë: Ju sjellim në vëmendje se për këtë procedurë, prokurohen artikuj, në sasi të mëdha. Ajo që kërkon AK është që të shpërndahen 185 artikuj të ndryshëm në 11 njësi levrimi, kërkesë kjo e ekzagjeruar dhe në tejkalim të dispozitave ligjore. Afati prej 15 ditësh nuk është i mjaftueshëm dhe nuk është në përputhje të drejtë me natyrën e kontratës. Artikujt objekt i kësaj kontrate, nuk janë prodhimi vendas, por importohen nga firmat prodhuese nderkombetare dhe kalojnë një sërë procedurash, të cilat në asnjë rast, nuk përmbillen brenda këtij afati..... Vlen të përmendim, se disa here, AK, ia kalojnë të gjithë barrën e emergjencave për furnizim, OE të interesuar për të fituar kontratën, nderkohe që kanë të gjithë mundësitë të bëjnë planifikimet e tyre në kohë, që të mos gjenden përballë “situatave emergjente”.*

Ju lutemi, mirekuptoni domosdoshmerinë e OE për një afat levrimiti minimalisht prej 30 ditësh dhe modifikoni këtë kriter.”

III.3.2. Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se:

“ Ju bëjmë me dije se artikujt janë prodhim vendas dhe mund të gjenden lehtësisht në treg dhe në sasinë që ne kërkojmë. Për sa i përket shpërndarjes së mallit në preventiv janë 11 kode buxhetore dhe ndarja bëhet për efekt të buxhetit. Bashkia Gjirokastër disponon 3 magazina dhe malli do të dorëzohet në këto dhe jo në 11 institucione sic ju pretendoni. OE do të vihet në dijeni në datën e lidhjes së kontratës.

Afati i lëvrimin do të bëhet nga 15 ditë në 20 ditë.

Pretendimi juaj qëndron pjesërisht.”

III.3.3. Referuar pretendimit të ankimuesit në lidhje me Afatin e lëvrimin të mallit, referuar argumenteve të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pavarësisht se autoriteti kontraktor ka pranuar të ndryshojë afatin e lëvrimin nga 15 ditë në 20 ditë, ky afat i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke iu referuar shifrave të dhëna në preventiv si (numri i artikujve 182 , apo sasia e tyre).

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor në argumentet në lidhje me këtë pikë të ankesës, trajtuar në vendimin e KSHA-së nuk është bindës në vendimin e tij për rritje të këtij afati me 5 ditë.

Me të drejtë OE ankimues kundërshton shtojcën 6 “Afatin e lëvrimin” si afat i pamjaftueshëm dhe i paargumentuar, ndaj kërkon rishikimin e tij me zgjatjen e afatit deri në 30 ditë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati i lëvrimin të shërbimit, kërkuar në DST, si edhe ndryshimet me Vendim të KSHA-së, është kohë e pamjaftueshme që i duhet operatorëve ekonomikë (fitues të mundshëm të procedurës së prokurimit) për të siguruar mallin e kërkuar në përputhje me specifikimet teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Referuar arsyetimit të mësipërm, Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë afatet e lëvrimin të shërbimit të kërkuar duke i ndryshuar ato.

Për sa më sipër referuar, kërkesa e operatorit ekonomik për afatin e lëvrimin qëndron.

III. 4. Operatori ekonomik pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 25.

25	Dosje me llastik 25x34,5 cm.
----	------------------------------

Permasat kaq fikse te detajuara deri ne milimentra kufizojne konkurrencen. Kerkojme qe te vendosni nje diapazon te permasave, ku te jete minimalisht ± 2 cm.

III.4.1 Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se:

“Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron pasi dosjet me llastik janë disa lloje dhe janë përcaktuar përmasat dhe nuk bëhen me dëshirë sipas përmasave që mund të pretendohen. Përmasat që ne kemi nevojë është ajo e sipërcituar.”

III.4.2. Referuar ankesës së operatorit ekonomik për artikullin 25, ku argumenton, *se kërkesa me përmasa fikse kufizon konkurrencë*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se OE me të drejtë ngre pretendime në lidhje me këtë artikull. Është detyrë e njëjësive përkatëse të AK-së të mirëargumentojnë specifikimet teknike për mallrat që do të prokurojnë, me qëllim që të jenë sa më të plota dhe të sakta. Në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për prokurim të mallrave është e rëndësishme të përcaktohen parametrat për të dhënë informacion të plotë për artikujt objekt-prokurimi. Specifikimet teknike duhet të ndihmojnë operatorët ekonomikë, e jo ti vendosin në vështirësi në përgatitjen e ofertave të tyre.

KPP gjykon, se Autoriteti Kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike duke hapur dipazonin e përmasave të artikullit 25.

Për sa me sipër referuar, pretendimet e ankimuesit për këtë artikullin 25 qëndrojnë.

III.5. Referuar ankesës se Operatori ekonomik i cili pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 50,

50	Gome 6*2*1.5 e bardhe
----	-----------------------

Permasat kaq fikse, te detajuara deri ne milimentra kufizojne konkurrencen. Kerkojme qe te vendosni nje diapazon te permasave.

III.5.1 Autoriteti Kontraktor, me vendimin Nr.5712 prot., datë 15.06.2023 të KSHA-së vëren se:

*“Për sa më sipër pretendimi juaj qëndron, ku përmasat do të ndryshojnë nga 6*2*1.5 në 6*2*2”*

III.5.2. Referuar ankesës së operatorit ekonomik për artikullin 50, në lidhje me përmasat, autoriteti kontraktor me ndryshimet e pranuar, përsëri jep përmasa të paqarta të cilat bëhen pengesë për operatorët ekonomikë. Njësia e prokurimit në përcaktimin e specifikimeve teknike duhet të jetë sa më saktë dhe e qartë në vendosjen e përmasave. Konkretisht për këtë artikull duhet të vendosë diapazon në lidhje me ato.

Për sa me sipër referuar pretendimet e ankimuesit për artikullin 50 qëndrojnë.

III.6.Referuar ankesës se Operatori ekonomik i cili pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikujt nr. 82 dhe nr. 92 me specifikimet:

82	Liber evidence stervitjeje A5 X2/2
92	Liber Raport nderhyrje A4 X 2/2x50 flete

Ankimuesi kërkon: *Pershkruani qarte specifikimet teknike te artikujve.*

III. 6.1 Komisioni i Prokurimit Publik referuar ankesës në lidhje me artikujt 82 dhe 92, trajtimin të KSHA në lidhje me këta artikuj, vëren se Njësia e prokurimit është përgjegjëse në përcaktimet e specifikimeve teknike për mallrat që kërkon të prokurojë. Referuar ankesës Komisioni gjykon, se specifikimet teknike për artikujt e sipërcituar, nuk janë të qartë dhe të plotë, duke u bërë shkak për ankesa nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar, për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht AK kërkon të blerë libra, për realizimin e të cilave kërkohen të dhëna të sakta, si formati, gjatësia dhe gjerësia, numri i fletëve, kapaku, si edhe përmbajtja e faqeve, shoqëruar me pamje të qarta të tabelave me nr. kolonash dhe rreshtash.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat objekt-prokurimi, si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Autoriteti kontraktor duhet të jetë më shumë i interesuar që operatorët ekonomikë të jenë të mirëinformuar dhe të kenë specifikime teknike të plota për artikujt që kërkohen, me qëllim që të ndihmojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave dhe realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat e AK-së.

Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë e saktësojë specifikimet teknike në lidhje me artikujt objekt-ankimi.

Për sa më sipër referuar, pretendimet e ankimuesit për artikujt 82 dhe 92 qëndrojnë.

III.7. Referuar ankesës se Operatori ekonomik i cili pretendon ndryshime në specifikimet teknike për artikullin 153 dhe 160 kërkuar me specifikimet:

153	Tampon vule	Ngjyra blu të jetë në kuti metalike , përmasa minimumi 8x12cm.
------------	-------------	---

Tamponet e vules mund te jene te ambalazhuara ne kuti metalike ose plastike. Per sa kohe qe kutia nuk ndikon ne funksionalitetin e produktit, kerkojme qe te hiqet kerkesa qe kutia te jete metalike.

Dhe

160	Tela për makinë kapse 24/6 ngjyre bronx
------------	--

Kerkojme qe te hiqet kerkesa qe telat te jene ngjyre bronx, pasi ngjyra nuk ndikon ne funksionalitet e produktit , perkundrazi, kufizon konkurrencen.

III.7.1 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Përcaktimi në mënyrë të detajuar i specifikave që nuk ndikojnë në funksionalitetin apo nuk vërtetojnë cilësinë e artikujve objekt-prokurimi si dhe përcaktimi i parametrave fikse, duke i kufizuar në mënyrë eksplicite ato, kufizon pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi, e për pasojë kufizon konkurrencën. Gjithashtu, konstatohet, se janë përcaktuar specifikime teknike që nuk ndikojnë aspak në funksionimin e mallrave objekt-ankimi, ku më shumë se shpjeguese, janë konfuze duke u bërë shkak për ankesa. Operatori ekonomik ankimues me të drejtë argumenton, se këto specifikime janë kufizuese dhe diskriminuese dhe nuk ndikojnë në funksionalitetin e mallrave.

Për sa më sipër referuar, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike:

- Për artikullin 153 të modifikojë specifikimet teknike *duke hequr termin metalik*, për sa kohë nuk ndikon në funksionalitetin e tij.
- Për artikullin 160 të modifikojë specifikimet teknike *duke hequr termin ngjyra bronx*, për sa kohë nuk ndikon në funksionalitetin e tij.

Për sa më sipër referuar, pretendimet e ankimuesit për artikujt 153 dhe 160 qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagesës për ankimimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-71121-05-31-2023, me objekt “Kancelari” me fond limit: 1.962.663 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastër.
2. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE duke hartuar shtojcën me ndryshimet dhe sqarimet sipas konstatimeve të këtij vendimi.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri

